



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-2041/21 datë:21.01.2021



Npi – 01/29 datë: 26.01.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 26.01.2021, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 26.01.2021 (e martë) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.01

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Rrahman Kadrija, znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, znj.Xhevahire Ramadani, z.Ruzhdi Brahimi, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri, Nga OSBE z.Muharrem Haziri. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Rrahman Kadrija, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më: 21.12.2020,
2. Raporti vjetor i punës të KPK-së për vitin 2020,
3. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPK-së për 2021,
4. Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më: 21.12.2020

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 21.12.2020.**

Pika 2

Raporti vjetor i punës të KPK-së për vitin 2020

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Diarta Vishesella; Përshëndetje, unë desha me pyet, te faqja e 3 e dokumentit në fund të faqes ku bëhet fjalë për projektet, a kanë përfunduar këto 6 shtëpi krejtësisht apo jo?

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Me u ndërtuar jaqnë ndërtuar, por tani jemi në fazën e tretë ku duhet me u meremetuar edhe me dyer e dritare. Pesë shtëpi janë në fazën e fundit të dorëzimit të tyre, përveq shtëpisë së Elmi Jakupit. Te disa janë përfunduar krejt e te disa ka edhe pak punë.

znj.Diarta Vishesella; Edhe nje pyetje tjetër e kam, edhe për sa familje jemi duke paguar qira banimi?

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, e njoftoi KPK-në, tani për tani i kemi edhe dy familje për të cilat paguajmë qira banimi me nga 120€ Sipas kontratave që na i kanë ofruar ata.

z.Fatmire Ferati; Përshëndetje, sa i përket raportit, unë po shpresoj se sivejt do ta realizojmë planin e punës më mirë, kjo për faktin se siç e dimë kemi ende pandeminë Kovid19 e cila ka ndikuar edhe në cilësi por edhe në numrin e mbledhjeve që nuk kemi mundur me i mbajtë.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, pa ujë nuk ka kurgjë hiq, ne nuk kemi ujë për pije, dhe shumë po kemi telashe. Kemi biseduar për këtë edhe me drejtorin Hamëz Tërshani, por deri tani nuk ka ndodhur asgjë. Qe 3-4 vjet e kemi këtë problem. Në rrugën “Anton Çeta” lagja “Eqrem Çabej” jemi katër familje të komunitetit Rom që kemi problem me ujin e pijes.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Këtë problem nuk e kanë vetëm komuniteti Rom por edhe pjestarët e komuniteteve tjera që jetojnë në atë lagje, sepse edhe ne jemi interesuar dhe kemi biseduar me përfaqësuesit e kompanisë së ujësjellësit. Unë kam biseduar edhe me përfaqësuesit e OJQ-së “Katari” për hapjen e puseve, dhe po shpresoj se sivjet kemi me bërë diçka.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, edhe ne si KPK-ë por edhe ZKKK-ja e kemi dhënë kontributin maksimal për realizimin e planit të punës. Po shpresoj që të kalon pandemia, dhe po i kthehemi normalitetit, edhe sigurisht që edhe plani i punës do të realizohet më mirë.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Unë ju falënderoj për bashkëpunim, sepse kemi arritur suksese të dukshme edhe përkundër problemeve që i kemi pasur. Ne si ZKKK-ë jemi munduar që të mbajmë një kordinim me të gjithë donatorët dhe komunitetin, kështu që kemi arritur të realizojmë projekte edhe publike por edhe individuale konkrete.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Ju falënderoj për bashkëpunimin, ndërsa unë jam munduar që të ju dal për ballë kërkesave të komunitetit ashkali, duke qenë edhe anëtarë i Shtabit Emërgjent për Pandeminë Kovid19.

z.Arton Demiri; E falënderoj Ibrahimin për faktin se nuk i ka nda komunitetet por ku ka pas nevojë për ndihmë ju ka dërguar, dhe ju ka ndihmuar.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së; Përshëndetje për të gjithë, unë e shfrytëzoj momentin që të ju falënderoj në emër të OSBE-së për sa i përket bashkëpunimit të mirë që e kemi pas me ju, po ashtu kërkoj edhe falje sepse ndoshta edhe ndonjëher ju kam lodhur me pyetje, por krejt ideja ka qenë që të kemi një bashkëpunim por edhe rezultat më të mirë në projekte dhe në avancimin e pozitës së komunitetit pakicë në komunën e Shtimes.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Edhe ne si Komitet për Komunitete, ju falënderojmë juve si OSBE- që i keni përcjellë dhe jeni duke i përcjellë mbledhjet tona, por falenderim keni edhe për ndihmën që na e keni dhënë në shumë projekte që kanë ndikuar te komuniteti ashkali e rom në komunën e Shtimes. Në vazhdim Kryesuesi konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Raportin vjetor të punës të KPK-së për vitin 2020.**

Pika 3

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPK-së për 2021

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademaj; Unë po besoj se zyrtari i Kuvendit z.Idajet Rexhepi, kur e ka përpiluar propozim-vendimin për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPK-së për vitin 2021 e ka pas parasysh faktin që datat të harmonizohen edhe me Kuvendin por edhe me Komitetet tjera. Por edhe nëse ka ndonjë rast ne mundemi me i ndryshuar datat e thirrjes së mbledhjes të Komitetit.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së; Unë vetëm desha ta potencoj një çështje që ka të bëjë me përgatitjen e rekomandimeve që dalin nga Komiteti. Mendoj se duhet të caktohet orari i mbledhjeve të Komitetit për Komunitete së paku 3-4 ditë përpara mbledhjeve të Kuvendit me arsyetimin që sekretaria e Kuvendit me pas kohë të mjaftueshme për me i përgatit Rekomandimet

e KPK-së dhe me i prezentu ato në mbledhjet e Kuvendit. Me këtë rast unë mundem vetëm me ju përgëzuar, sepse procedurat dhe mënyra mirë e organizuar e punës që e bënë zyrtari i Kuvendit z.Idajet Rexhepi, por edhe Kordinatori i ZKKK-së z.Ibrahim Demiri, meriton vetëm lëvdata. Nuk kemi pas asnjëherë asnjë problem për ta siguruar ndonjë dokument ose informatë, dhe kjo është bërë mbrenda shumë pak minutave, vërtetë kështu nuk mundesh me gjetë në komuna tjera.

z.Idajet Rexhepi, bashkëpunëtor profesional i Kuvendit; Përhëndetje për të gjithë, fillimisht i falënderoj të gjithë për fjalët e mira që u thanë për mua, posaqërisht nga përfaqësuesi i OSBE-së z.Muharrem Haziri, që ishte i rregullt gjithëherë në monitorimin e punës së Komitetit për Komunitete. Sa i përket Propozim-Vendimit për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPK-së për vitin 2021, unë e kam përgatitur dhe sigurisht që e kam pas parasysh edhe orarin e mbledhjeve qoftë të Kuvendit por edhe të Komiteteve tjera. Ato i kam harmonizuar, dhe tani nëse ka propozime për të ndryshuar ndonjë datë, atëher duhet të shikohen edhe orari i mbledhjeve tjera që të përshtatet. Sa i përket kohës së mjaftueshme për përgatitjen e Rekomandimeve po ashtu e kemi pas parasysh dhe mund të them se nuk do të ketë ndonjë problem për ti përgatitur dhe prazantuar në mbledhjet e Kuvendit.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -I- për vitin 2021, të mbajtur më : 26.01.2021, unanimitisht aprovoi Vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve për vitin 202, si vijon:

<i>Nr</i>	<i>Data</i>	<i>Muaji</i>	<i>Viti</i>	<i>Dita</i>	<i>Ora</i>
1	26	Janar	2021	e hënë	14.00
2	23	Shkurt	2021	e martë	14.00
3	29	Mars	2021	e hënë	14.00
4	26	Prill	2021	e hënë	14.00
5	27	Maj	2021	e enjte	14.00
6	22	Qershor	2021	e martë	14.00
7	06	Korrik	2021	e martë	14.00
8	27	Gusht	2021	e premte	14.00
9	21	Shtator	2021	e martë	14.00
10	26	Tetor	2021	e martë	14.00
11	26	Nëntor	2021	e premte	14.00
12	16	Dhjetor	2021	e enjte	14.00

Pika 4

Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Ibrahim Demirit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Pasi përhëndeti të gjithë të pranishmit, njoftoi KPK-në për aktivitetet e zhvilluara, si vijon: Kërkesa për kthim nuk kemi pasuar gjatë tërë vitit 2020 dhe nuk kemi as këtë muaj. Nuk kemi pasur asnjë të riatdhesuar gjatë këtij muaji.

Nga MPMS-ja ka përfunduar ndërtimi edhe i shtëpisë së gjashtë, për Elmi Jakupin, përderisa pesë shtëpitë e tjera janë në përfundim e sipër, por ende nuk është bërë pranimi i tyre nga përfituesit.

Sa i përket programit të IOM-it, për projekte individuale dhe për projekte për investime në infrastrukturë, të gjitha kanë përfunduar. Komuna, me shumën 4280€ ka participuar për projektin e infrastrukturës-Ndriçim Publik në Gjyrkovc dhe Vojnovc, ku shuma e përgjithshme është 18.280€. Më datën 14.1.2021 është bërë pranimi i projektit ku është konstatuar se kanë përfunduar të gjitha punët, sipas kontratës që ka nënshkruar IOM me kontraktorin e ku mbikëqyrës i projektit, me vendim të kryetarit të komunës, ka qenë z. Gojart Bajrami, nga drejtoria për Shërbime Publike. Nga projektet individuale për përkrahje të bizneseve ekzistuese apo biznese të reja, IOM-i ka realizuar dhe ka pajisur me mjetet e punës edhe përfituesin e pestë Avi Ilazin, nga fshati Gjyrkovc ku si ZKKK kemi asistuar në pranim, gjatë këtij muaji. Përfituesit e tjerë janë pajisur me mjetetet e kërkuara në fund të muajit dhjetor 2020(Durak Maliqi, Mehmet Mehmeti,

Daut Kodrolli, Liman Mehmeti- të gjithë të komunitetit ashkali). Gjatë kohës së pandemisë kemi shtuar bashkëpunimin me Shoqatën Humanitare “Loti Jetimit”, Shoqatën Humanitare “Rahmeti”, Shoqatën “Prishtina-Këshilli Koordinues Xhamia e Llapit”, Shoqatën “Buzësheja e një Jetimi”, Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” dhe Diasporën. Nga ky bashkëpunim, si rezultat, janë ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike pothuajse të gjitha familjet e komuniteteve ashkali dhe rom.

Kemi bashkëpunuar vazhdimisht me QPS-në për hartimin e listave prioritare për 160 familje të komunitetit ashkali dhe rom (sa janë gjithsej në komunën e Shtimes), për ndihmë, dhe është arritur që gjatë vitit të shpërndahen mbi 1300 pako ushqimore dhe higjienike për këto familje, qoftë nga buxheti i komunës, qoftë nga donatorët me të cilët kemi bashkëpunuar. Si ZKKK gjatë vitit 2020 kemi pranuar 26 kërkesa (24 individuale dhe 2 nga OJQ-të), dhe 25 prej tyre i kemi realizuar. Për realizimin e këtyre kërkesave ZKKK ka shpenzuar buxhetin prej 6500€, po me ndihmë dhe aktivitetet e anëtarëve të KPK-së, komunitetet kanë përfutur edhe nga burimet e tjera, si:

o MASHT-WORAE-Bursa për nxënës të shkollës së mesme	6000€
o Ndriçim publik në fshatin Vojnoc dhe Gjyrokoc, IOM+Komuna	17.713.56€
o Vetëpunësim-5 Projekte nga IOM	2070.84€
o QPS- 400 pako ushqimore nga 25€	10.000€
o Shoqata Humanitare “Rahmeti”, “Loti Jetimit”, “Buzësheja një Jetim”- 500 pako ushqimore dhe material higjienik nga 20€	10.000€
o UNHCR- Kryqi Kyq, BSFK “Advancing Togedher” -200 pako ushqimore dhe material higjienik nga 25€	5000€
o Ndihma nga diaspora me 200 pako ushqimore dhe material higjienik nga 30€	6000€
o Zyra e Kryeministrit (ZKÇK)	3300€
o DKRS për shënimin e Ditës së Flamurit të Komunitetit Ashkali	450€
o DSHMS-ndihm për pjesëtarët e komuniteteve	1350€
o Ndihmë nga bamirësit për hapjen e 5 puseve (bunarëve) tek familjet në nevojë.	3500€

Ndër sfidat kryesore që kemi hasur gjatë vitit 2020 janë: 1. Vonesa e ndërtimit të shtëpive nga MPMS, për rastet sociale. 2 Strehimi i familjeve me rastin e vërshimeve.

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ruzhdi Brahimi; Përsëritet për të gjithë. Ti Kryesues edhe Ibrahim, me projekte Shtimen e keni anashkaluar, a mund të na thuani pse? Sepse te Lagja që i thojnë te Mulliri i Tafës, nuk ka as ndriçim as kurgja hiç, pra po bëhet fjalë për rrugën “Ardhmëria” dmth. rruga që fillon nga ordianca “Vita” e tutje nuk ka ndriçim. Pastaj është problem i madh edhe me Qenët endacak.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Unë do ta përcjelli, këtë shqetësim në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, sepse marrë pjesë aty, dhe do ta përcjelli edhe këtë çështje por edhe problemin e telave të energjisë elektrike në Gjyrokoc që po paraqesin rrezik.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15.05 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija